



**KËSHILLI BASHKIAK
TIRANË**

V E N D I M

Nr. 64, datë 26.09. 2016

Për

**“MIRATIMI I PAGESËS PËR PAK E INVALIDËT E PUNËS
PËR PERIU DHËN 1-30 SHTATOR 2016”**


Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetqeverisjen Vendore”; neneve 7, 8, 11, 20, 23 dhe nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e Invalidëve të Punës” (i ndryshuar); Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” (i ndryshuar); Ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000, “Për statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.01.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 618, datë 07.09.2006, “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 869, datë 18.06.2008 për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Statusi i Invalidit të Punës”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 07.02.2007 “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.3, datë 10.03.2014 “Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr. 22, datë 20.08.2015, mbi zbatimin e vendimit nr.618 datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr. 9, datë 25.02.2015, mbi zbatimin e vendimit nr. 404 datë 20.06.2012 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së kriterëve dhe procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbërit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”; Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr. 23, datë 20.08.2015, mbi zbatimin e vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr. 24, datë 20.08.2015 mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbërit” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak Tiranë, sa më poshtë:

VENDOSI:

1. Të miratohet pagesa për personat me aftësi të kufizuar, për muajin Shtator 2016 për Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë sipas tabelës nr 1 bashkëlidhur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen Vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETAR

ALDRIN DALIPI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Aldrin Dalipi', is written over a circular dotted stamp. The signature is fluid and cursive, with a prominent vertical stroke on the left side.

PERMBLEDHESHE E PERSONAVE ME AFTESI TE KUFIZUAR QE PERFITOJNE PAGESA TE MBROJTIES SOCIALE PER MUAJIN

shtator 2016

ne Leke

Nr.	Njësiti Administrative	TE VERBER		KUDESTAR PER TE VERBER		PAK FIZIK, MENDOR		KUDESTAR PAK FIZIK		PARAPLEGJIK TETRAPLEGJIK		KUDESTAR PARA/TETRAPLE		INVALID PUNE		TOTALI	
		Nr.	Fondi	Nr.	Fondi	Nr.	Fondi	Nr.	Fondi	Nr.	Fondi	Nr.	Fondi	Nr.	Fondi	Nr.	Fondi
1	Nr. 1	111	1.510,681	33	375,870	319	3.230,896	75	722,160	37	1.123,182	36	379,080	932	2.907,500	1.543	10.249,369
2	Nr. 2	151	2.019,652	41	466,990	396	4.145,627	102	1.018,045	81	2.313,136	78	837,090	1.232	3.843,900	2.081	14.644,440
3	Nr. 3	115	1.835,017	39	421,430	273	2.637,890	78	792,370	52	1.519,508	52	537,030	993	3.017,200	1.602	10.760,445
4	Nr. 4	144	1.699,435	33	387,260	506	4.834,460	97	1.421,165	71	1.836,070	69	662,890	1.160	3.393,600	2.080	14.234,880
5	Nr. 5	157	1.850,582	49	558,110	414	3.979,656	135	1.479,425	63	1.712,906	61	621,270	1.273	3.869,700	2.152	14.071,649
6	Nr. 6	168	2.131,139	50	569,500	503	5.161,900	129	1.298,885	72	1.941,190	72	758,158	1.062	3.427,000	2.056	15.287,772
7	Nr. 7	141	1.982,929	47	535,330	362	3.752,134	108	1.158,300	69	1.916,200	68	726,570	1.133	3.589,300	1.928	13.660,763
8	Nr. 8	113	1.442,312	28	284,750	251	2.452,472	75	752,250	36	1.275,376	36	346,990	808	2.544,100	1.347	9.098,250
9	Nr. 9	136	1.725,058	32	364,480	360	3.718,116	95	962,880	59	1.633,770	59	600,210	1.025	3.138,100	1.766	12.142,614
10	Nr. 10	58	738,608	16	148,070	133	1.238,842	44	381,140	22	634,324	22	210,600	527	1.571,900	822	4.923,484
11	Nr. 11	102	1.368,506	38	489,770	475	4.832,814	99	1.093,270	73	2.037,350	73	768,690	978	3.232,700	1.838	13.823,100
12	Petrole	11	135,530	3	34,170	73	722,160	9	90,270	22	625,002	21	226,395	65	224,900	204	2.058,427
13	Farke	24	361,103	6	68,340	102	1.045,712	21	215,645	18	495,020	18	189,540	134	463,600	323	2.838,960
14	Dajt	32	382,690	10	113,900	124	1.467,380	29	310,930	22	582,720	22	230,600	166	567,100	405	3.655,320
15	Zall-Bastar	25	294,014	4	45,560	115	1.173,510	18	200,600	12	126,936	12	318,360	62	206,800	248	2.365,780
16	Berzhite	18	237,292	9	102,510	68	684,616	11	110,330	9	247,510	9	94,770	72	213,900	196	1.690,928
17	Krrabe	9	118,646	3	34,170	38	371,758	7	75,225	2	57,356	2	21,060	46	136,900	107	815,115
18	Baldushk	27	347,994	15	159,460	75	802,400	10	100,300	1	26,030	1	10,530	46	159,100	175	1.605,814
19	Shengjergji	4	52,960	3	34,170	38	401,200	9	90,270	4	104,120	4	50,120	29	95,700	91	828,540
20	Vagarr	27	383,062	6	68,340	87	876,474	17	170,510	12	336,192	12	126,360	87	279,400	248	2.240,338
21	Kashar	53	768,180	19	205,020	232	2.298,166	68	631,890	28	863,568	28	284,310	305	964,000	733	6.015,134
22	Peze	19	216,410	14	159,460	61	611,830	8	80,240	6	156,180	6	63,180	63	199,000	177	1.486,300
23	Ndroq	73	737,342	14	140,420	12	309,600	12	121,095	25	353,940	12	136,680	75	243,000	223	2.042,077
24	Zall-Herr	26	319,388	10	125,290	105	1.123,360	20	190,570	15	398,450	15	157,950	120	375,000	311	2.690,008
	TOTALI	1.744	22.658.530	522	5.892.370	5.122	51.872.973	1.276	13.467.765	811	22.316.036	788	8.358.433	12.393	38.663.400	22.656	163.229.507

